

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 609 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 58, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor të ri, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Kisha e Shën Mërisë Mamurras"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), doktorante Znj. Brunilda Bregu, drejtues Prof. Luan Përzhita, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor të ri, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Kisha e Shën Mërisë Mamurras"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), doktorante Znj. Brunilda Bregu, drejtues Prof. Luan Përzhita, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Pastrim i përgjithshëm i neftit qendror
 - Sondim në verilindje të absidës qendrore
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë periudha kohore e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO PURXHI
MINISTËR

SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al